

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “REJ”

Adresa: Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-13446-07-17-2024.

Number of procedure/lot reference:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Shërbim pastrimi i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme, për nevoja të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë”,

me fond limit: 135,391,381.34 (njëqind e tridhjetë e pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e njëmijë e treqind e tetëdhjetë e një pikë tridhjetë e katër) lekë pa tvsh, ose 1,349,595.11 (njëmilion e treqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë njëmbëdhjetë) Euro pa TVSH,

me afat marreveshje kuadër 48 (dyzet e tetë) muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.40 datë 22.07.2024, Nr. 67 datë 07.10.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

- | | |
|---|-------------------------|
| 1. REJ | J93711608Q |
| Emri i plotë i shoqërisë | numri i NIPT-it |
| Vlera: 101,964,145.86 (njëqind e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet e pesë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH | |
| 2. S I L V E R | K88010301S |
| Emri i plotë i shoqërisë | numri i NIPT-it |
| Vlera: 107,684,860 (njëqind e shtatë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH | |
| 3. CLEAN FAST | L61807037R |
| Emri i plotë i shoqërisë | numri i NIPT-it |
| Vlera: 113,286,359 (njëqind e trembëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH | |
| 4. Pastrime Silvio | K91413010N |
| Emri i plotë i shoqërisë | numri i NIPT-it |
| Vlera: 131,237,546 (njëqind e tridhjetë e njëmilion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH | |
| 5. SORI-AL | K31510059D |
| Emri i plotë i shoqërisë | numri i NIPT-it |
| Vlera: 133,465,020.29 (njëqind e tridhjetë e tremilion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e njëzet pikë njëzet e nëntë) lekë pa TVSH | |
| 6. AIR | L51712008C |
| Emri i plotë i shoqërisë | numri i NIPT-it |
| Vlera: 92,968,233 (nëntëdhjetë e dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH. | |
| 7. BOE: "ALPEN PULITO & KURTI-07" | K61516506H & K73814201W |

Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 101,576,130.036 (njëqind e një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. AIR

L51712008C

Përkatësisht për arsyet si më poshtë:

Operatori ekonomik “AIR ”sh.p.k, me NUIS : L51712008C nuk përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar mbi xhiron vjetore jo më e vogël se 40 % e fondit limit në të paktën 1 vit nga tre vitet e periudhes (2021,2022,2023), për këto arsye:

Për këtë kërkesë OE ofertues ka aparqitur vërtetim e xhiros Nr. T11227304 ku rezulton se xhiro e realizuar, viti më i mirë i këtij subjekti është 46,674,200 lekë e cila rezulton vlerë më e vogël se vlera e kërkuar në DT është 40% e Fondit limit=54,156,552 lekë.

Gjithashtu subjekti ka ngarkuar në SPE një deklaram me shkrim të subjektit DEVIS sh.p.k. ku ky i fundit merr përsipër të mbështesë ofertuesin me kapacitete financiare në lidhje me xhiron vjetore. Nga shyrtimi i dokumenteve të paraqitura KVO konkludoi se dokumentacioni për mbështetjen në kapacitetet financiare të DEVIS sh.p.k i paraqitur nuk plotëson kërkesat dhe kushtet e pëcaktuara në Rregullat e Prokurimit dhe Dokumentat e Tenderit për arsye se:

- Së pari ofertuesi AIR sh.p.k nuk e ka deklaruar mbështetjen në kapacitetet e “Devis” sh.p.k. në Formularin e Vetdeklarimit nderkohe që kjo perben detyrim i përcaktuar në VKM 285 dt.19.04.2021 “Rregullat e prokurimit publik” nenin Neni 90, pika 2 paragrafi 1, si dhe Dokumentat Standart të Tenderit, Shtojca 9 e DST, Rubrika B, Paragrafi i dytë , Titulli “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik”.

- Së dyti, bazuar në pikën 3, të nenit 84 të LPP, pikën 2 të nenit 90 të RrPP dhe parashikimet në shtojcën 8 të DST, Paragrafi 15 ku përcaktohet “Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës , si dhe shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” ku përcaktohet “Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”. Me qëllim provimin AK se për subjektin mbështetës DEVIS sh.p.k nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, duhej të ishte plotësuar, nënshkruar dhe paraqitur Formulari i Vetdeklarimit nga subjekti mbështetës “DEVIS” sh.p.k.

- Nuk përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pasi pasqyrat financiare për vitin 2023 të paraqitura janë të pakonfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Referuar paragrafit të fundit të shtojcës 8 “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”, mosparaqitja e dokumentacionit në formën e pasaktë ligjore përbën arsye për skualifikim.

2. BOE: “ALPEN PULITO & KURTI-07”

K61516506H & K73814201W

Përkatësisht për arsyet si më poshtë:

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës nuk plotësojnë kushtet ligjore për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, pasi dokumentacioni është paraqitur në kundërshtim përcaktimet ligjore sipas VKM 285 dt.19.04.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, nenin Neni 88, pika 1 dhe 2 e konkretisht:

- Referuar marrëveshjes së bashkimit të përkohshëm Nr.907 Rep, 270 Kol, dt 18.08.2024, rezulton se palët nuk kanë përcaktuar pjesën konkrete të shërbimit që do të kryejë secili nga anëtarët e BOE. OE pjesëmarrës kanë përcaktuar në kontratë vetëm përqindjen e pjesëmarrjes në BOE duke vepruar në kundërshtim me nenin 88 pika 1 të VKM nr.285, ku përcaktohet se: “Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

- Bashkimi i përkohshëm midis dy subjekteve nuk plotëson kërkesat pikes 2 të Nenit 88 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” pasi sigurimi i ofertës Nr Serie 240605868 dt.19.08.2024, është paraqitur në emër të subjektit ALPEN PULITO sh.p.k dhe jo në emër të BOE, në kundërshtim me parashikimet e VKM ku përcaktohet se “Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.”

- Anëtari i BOE “KURTI-07” sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sipas pikës 2.3.1 “Kapaciteti Teknik” në lidhje me shërbime të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit dhe përcaktimet e pikës 3 të Nenit 88 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Konkretisht anëtari i BOE subjekti KURTI-07 sh.p.k, duhet të plotësonte me dokumentacionin përkatës kërkesat për shërbimet e ngjashme, në përputhje me 40% të pjesëmarrjes në shërbim, por subjekti nuk ka paraqitur asnjë kontratë apo faturë të realizuar në lidhje me objektin e prokurimit.

- Anëtari i BOE “KURTI-07” sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sipas pikës 2.2.1 “Kapaciteti Financiar”, pasi pasqyrat financiare për vitet 2021, 2022, 2023 të paraqitura janë të pakonfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe nuk janë të shoqëruar Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, sipas përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Ky vlerësim lidhet me faktin se subjekti ka aktive mbi 50 milion leke në dy vite të njëpasnjëshme dhe xhiro vjetore mbi 100 000 000 lekë.

3. S I L V E R

K88010301S

Përkatësisht për arsyet si më poshtë:

Bazuar në vendimin e KPP Nr. 70/2025 dt. 14.01.2025, operatori ekonomik “Silver” sh.p.k skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm:
“REJ”, me Nuis J93711608Q, dhe adresë: Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2, Tiranë, i cili ka paraqitur ofertën me vlerë totale prej 101,964,145.86 (njëqind e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e dyzet e pesë pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues i procedurës së prokurimit.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), për nënshkrimin e marrëveshjes kuadër, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO ☒ JO ☐

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Vendim i KPP Nr.70/2025, me nr. 2900/7 prot., datë 14.01.2025

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO ☐ JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____